

FTESË PËR APLIKIM PËR GRANTE DHE TRAJNIME NË BUJQËSI DHE PËRPUNIM, KOMUNA SHITES & VUSHTRRI

Organizata "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK), është duke zbatuar projektin *"Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit"* projekt tre-vjeçar (2024-2026), i përkrahur nga donatori Zvicran FRIEDA. Projekti ka shtrirje në këto komuna: **Shtime, Vushtrri, Lipjan dhe Mitrovicë** të cilat janë partnere të projektit. Gjatë vitit 2026 projekti do të zbatohet në komunën e **Shtimes dhe Vushtrrisë**.

Projekti ka për qëllim tri komponentet kryesore të përkrahjes, si: *Ngritja e kapaciteteve përmes Arsimit dhe Aftësisimit Profesional, Mbështetja me grante për krijimin e kushteve për gjenerimin e të ardhurave dhe vetëpunësim, si dhe Promovimi i përfshirjes së të rinjve, grave dhe burrave nga zonat rurale në bujqësi*.

Mbështetja e grave dhe burrave me grante: Në kuadër të aktiviteteve të projektit në komunën e Shtimes dhe Vushtrrisë do të përkrahen fermer/e përfitues me grante (në vlerë mesatare 2,000 Euro) në sektorin e bujqësisë (në nënsektorë të ndryshëm të bujqësisë si: perimtar, pemëtar, bletar, blegtor etj). Andaj ftohen fermerët, gratë dhe burrat që të aplikojnë për grantet e lartëcekura.

Kriteret që duhet plotësuar të rinjtë për grante janë:

- Të jenë me moshë mbi 25 vjeç;**
- Të jenë nga zonat rurale të komunës së Shtimes dhe Vushtrrisë;**
- Të jenë të papunë dhe aktivë në veprimtaritë bujqësore;**
- Të kenë resurse për t'u angazhuar në bujqësi (tokë, uji, fuqi punëtore);**
- Të jenë të interesuar për të filluar një biznes apo për t'u vetëpunësuar;**
- Gratë kryefamiljare do të kenë përparësi të përgjeshme;**

Aplikacionet për mbështetjen me grante duhet të dorëzohen deri me datë 02.03.2026, në ora 16:00.

Mbështetja e grave me trajnime profesionale dhe grante në sektorin e përpunimit: Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar formimi i dy grupve me 15 pjesëmarrëse për secilin grup nga komuna e Vushtrrisë dhe Shtimes përfshirë në projekt, për të cilat do të organizohen 20 ditë trajnime profesionale për secilin grup në sektorin e përpunimit (pemë dhe perime, qumësht apo ëmbëlsira) të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Pas përfundimit të trajnimeve gratë do të pajisen me certifikata të lëshuara nga IADK dhe të verifikuara nga AKK. Pas certifikimit kandidatja më e suksesshme e grupit do të mbështetet me pajisje për njësi të përpunimit, ndërsa kandidatet tjera do të mbështeten me grante të vogla.

Kriteret që duhet plotësuar Gratë për trajnime në përpunim janë:

- Të jenë mbi moshën 16 vjeç;**
- Të jenë nga zonat rurale të komunës së Shtimes apo Vushtrrisë;**
- Të jenë të papuna dhe aktive në përpunim;**
- Të kenë potencial për zgjerim të kapaciteteve të përpunimit;**
- Të jenë të interesuara për të filluar një biznes apo për t'u vetëpunësuar;;**
- Gratë kryefamiljare do të kenë përparësi të përgjeshme.**

Programi modular është i Akredituar dhe i validuar nga Autoritetit Kombëtar i Kualifikimit dhe realizohet në pjesën teorike me 30% dhe pjesën praktike 70%.

Aplikacionet për mbështetjen e grave me trajnime profesionale dhe grante në sektorin e përpunimit duhet të dorëzohen deri në datë 02.03.2026, në ora 16:00.

Aplikacioni mund të merret dhe të dorëzohet në zyrën e IADK-së dhe zyret për bujqësi në komunën e Shtimes dhe Vushtrrisë, ose mund t'i kërkonit dhe dorëzoni: në e-mailin: djellzaa.zejnullahu@gmail.com apo officer.c@iadc.org.